



**VENDIM**

*Nr. 11, Datë 06.02.2014*

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENSËS SË  
SHOQËRISË KESH SH.A NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”; neneve 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.02.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “KESH Sh.a”, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**VENDOSI :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.03.2009.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**

*Nr. 11 Date 06 .02.2014*

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR RINOVIMIN E LIÇENSËS SË  
SHOQËRISË KESH SH.A NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	<b>Pro</b>	<b>Kundër</b>
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____